3. Autoriteti/Enti Kontraktor mund t'i kërkojë Komisionit të Prokurimit Publik që të lëshojë masa të ndërmjetme për mospezullimin e procedurës së prokurimit.

E. ANULIMI I PROCEDURËS

26. Anulimi i procedurës

1. Autoriteti / Enti kontraktor publikon vendimin përfundimtar për Anulimin e Procedurës së Prokurimit, në të njëjtën mënyrë siç publikon Njoftimin e Kontratës, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e skadimit të afatit të fundit për paraqitjen e ankesave, ose dhënien e vendimit përfundimtar për ankimin.
2. Autoriteti/ Enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur:
 - a) nuk është paraqitur asnjë kërkesë e përshtatshme në procedurat me faza;
 - b) nuk është paraqitur asnjë ofertë e përshtatshme në procedurat me një fazë;
 - c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;
 - d) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit ose entit kontraktor ka ndryshuar;

e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP;

Gjithashtu, Titullari i autoritetit/entit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 të LPP dhe nenin 75 të VKM 285/2021, të ndryshuar.

3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti/enti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.

4. Nëse, Autoriteti/Enti Kontraktor duhet të rishpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna, nuk duhet të vijojë me rishpalljen e saj në Sistemin e Prokurimit Elektronik përpara përfundimit të afateve të ankimimit/shqyrtimit të ankesave dhe vendimit të marrë lidhur me to.

SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1: Formulari i Ofertës Ekonomike

Shtojca 2: Formulari i Ofertës ekonomike, për procedurat e prokurimit për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, kur aplikohet si kriter vlerësimi oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmimin më të ulët nga operatori ekonomik

Shtojca 3: Listat e Çmimeve të artikujve

Shtojca 4: Formulari i Sigurimit të Ofertës

Shtojca 5: Lista e Informacionit Konfidencial

Shtojca 6: Formulari i Specifikimeve Teknike

Shtojca 7: Formulari i Sasisë dhe Grafikut i lëvrimit

Shtojca 8: Formulari i Kritereve të Përzgjedhjes së Ofertuesve

Shtojca 9: Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit

Shtojca 10: Formulari i Njoftimit të Skualifikimit

Shtojca 11: Formulari i Njoftimit të Fituesit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Shtojca 12: Formulari i Njoftimit të Fituesit, në përfundim të afateve të ankimit

Shtojca 13: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimit

Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër, në përfundim të afateve të ankimit

Shtojca 15: Formulari i Njoftimit të Anulimit të Procedurës së Prokurimit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimit

Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE⁴

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt: **[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.

b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.

c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit/Entit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Mallrat për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.

d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:

1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
2. Njoftimin e Kontratës;
3. Kriteret e Përzgjedhjes;
4. Specifikimet teknike, grafikun e lëvrimit dhe sasinë e kërkuar;
5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
7. Listat e Çmimeve të Artikujve.

e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

⁴ Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 2.

[Në rastin e procedurave të prokurimit për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, kur aplikohet si kriter vlerësimi oferta ekonomike më e favorshme bazuar në çmimin më të ulët, nga operatori ekonomik plotësohet dhe paraqitet vetëm kjo Shtojcë]

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE⁵

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.

b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.

c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit/Entit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Mallrat për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.

c) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:

1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
2. Njoftimin e Kontrates;
3. Kriteret e Përzgjedhjes;

⁵ Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

4. Specifikimet teknike, grafikun e lëvrimit dhe sasinë e kërkuar;
5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
6. Kushtet e Veçanta të Kontratës.

d) Norma e fitimit e shprehur në vlerë absolute është si më poshtë:

1	2	3
Nr.	Përshkrimi i mallrave	Norma e fitimit e shprehur ne vlerë absolute

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Kujdes: Bazuar në parashikimet e nenit 45/2.1 të VKM Nr. 285/2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, kur si kriter vlerësimi përdoret “oferta ekonomikisht më e favorshme bazohet në çmimin më të ulët”, autoriteti/enti kontraktor përllogarit çmimin bazuar në:

- a) çmimin e bursës, së datës kur është publikuar njoftimi i kontratës së procedurës së prokurimit, i konvertuar sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë të kësaj date
- b) elementet fiskale;
- c) normën e fitimit të shprehur në vlerë absolute, e cila duhet të jetë e pandryshuar gjatë gjithë kohës së zbatimit të kontratës;

Shtojca 3.*(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)***LISTA E ÇMIMEVE TË ARTIKUJVE****Data:** _____**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:**
_____**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE):** _____**Monedha:** _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të zbatohen rregullat e përcaktuara në Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë artikujt në këtë Formular duhet të plotësohen dhe t'u vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për artikujt. Artikujt pa vlerë do të konsiderohen si artikuj të paofruar dhe do të çojnë në refuzimin e ofertës.

Lista e Çmimeve

1	2	3	4	5	
Artikulli	Përshkrimi i mallit	Sasia	çmimi per njesi	Çmimi total për artikull (3 x 4X)	
1.					
2.					
3.					
4					
	Çmimi total (Mallrat)				_____
Çmimi Neto pa TVSH					
TVSH (%)					
Çmimi total me TVSH:					
Emri i përfaqësuesit të ofertuesit					

Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 4.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: *[Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]*

Në emër të: *[Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]*

* * *

Procedura e prokurimit *[lloji i procedurës]*

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[objekti]*

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike *[Data]* *[Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-së.*

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e *[emri i autoritetit/entit kontraktor]* vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në *[njoftimin e kontratës]*.

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 5.

(Shtojcë për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 6.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet /entet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për efikasitetin e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;

b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit në mjedis;

c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.

Skicimet, parametrat teknik etj:


Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

SPECIFIKIMET TEKNIKE

1-SHTYLLA BETON ARME TË CENTRIFUGUARA

Shtylla 8m (vetëm mbështetëse në rastin e riparimeve)



Kriteret e ndërtimit	Njësia	Gjatësia/Forca (m/kN) Shtylla 8/6
Gjatësia	m	8
Diametri d1	mm	130-150
Diametri d2	mm	240-260
Vlera e forcës nominale operuse	kN	6

2- KRAH NDRIÇIMI I ZINGUAR Ø 50 ME DY FASHETA Ø150mm- Ø200mm

Krahu i ndriçuesit shërben për fiksimin e ndriçuesit në shtyllën e betonit arme.

Diametri i tubit të çelikut duhet të jetë Ø 50 mm dhe tubi duhet të jetë **(KRAHË NDRIÇUESI)** i zinguar **(për ti rezistuar kushteve atmosferike)**.

Gjatësia e krahut të jetë 1,1-1,5 metër **(për të realizuar këndin e ndriçimit)**.

Tubi gjithashtu duhet të jetë i pajisur me dy fasheta për tu fiksuar në shtyllë betoni arme **Ø150mm - Ø200mm**.

Krahu duhet të jetë i pajisur me bulonat që shërbejnë për fiksimin e tij.

Krahu duhet të ketë formë të harkuar në mënyrë estetike.

3- QAFORE PER SHTYLLA BETONI ARME ME $\varnothing 150\text{mm}$ - $\varnothing 200\text{mm}$

Qaforja shërben për kapjen e tirantuesëve.

Qaforja duhet të jetë llamarinë çeliku e zinguar me katër pika fiksimi për varjen e tirantuesave.

Qaforja duhet të jetë me qëndrueshmëri mekanike ndaj forcës tërheqëse të kabllit, dhe qëndrueshmëri ndaj agentëve atmosferikë.

Qaforja duhet të ketë mundësi fiksimi në varësi të diametrit të shtyllës me bulona të regjistrueshëm dhe fiksimit të shpejtë, të lehtë e të qëndrueshëm.

Mundësia e regjistrimit të diametrit të qafores të jetë deri 200 mm në varësi nga diametri i shtyllës në lartësinë e fiksimit të qafores.



4-KONEKTOR LINJE

Konektorë linje përdoret për lidhjen e përcjellësit degëzues me përcjellësin magjistril me ose pa seksione të njëjta.

Goma speciale siguron hermeticitet dhe qëndrueshmëri ndaj rrezatimit UV dhe ndikimeve atmosferike.

Konektori duhet të ketë qëndrueshmëri ndaj korrozionit elektrostatik dhe të realizojë kontaktin e përcjellësve të aluminit dhe bakrit nëpërmjet shtërngimit të bulonave fiksues.

Përdoret për përcjellës magjistril 35 mm² deri 150 mm² dhe përcjellës degëzues 35 mm² deri 150 mm².



5- KONEKTOR ABONENTI

Konektori përdoret për lidhjen e përcjellësit degëzues për konëktim abonentit dhe ndriçim publik. Ky konëktim mund të realizohet nën tension.


Konektori duhet të jetë rezistent ndaj ndikimeve atmosferike dhe rrezatimit UV.

Goma speciale hidroizoluese e përbërjes siguron këtë rezistencë.

Konektori duhet të realizojë kontakt elektrik të përcjellësit të aluminit ose bakrit.

Njëra anë e konektorit shërben për magjistralin kryesor nga 6 - 150 mm² dhe ana tjetër shërben për degëzim 4-35 mm².

Fiksimi i kabllave bëhet nëpërmjet bulonit fiksues.



6- NDRIÇUES RRUGOR LED 4000 K 100W-120W

Burimi i ndriçimit Led Module **(për kursim energjie dhe jetëgjatësi të ndriçuesit).**

Jetëgjatësia e ndriçuesit duhet të jetë jo më pak se 65000 orë pune, mbi 5 vjetë. **(për të evituar avaritë e shpeshta).**

Fuqia e Led 100 W - 120W **(për të përmbushur fluksin e ndriçimit dhe të ketë konsum të moderuar).**

Tensioni furnizimit 220-240 V **(tensioni më të cilin operon sistemi ynë kombëtar).**

Frekuenca e rrjetit 50-60 Hz **(frekuenca më të cilin operon sistemi ynë kombëtar).**

Efiçenca e Led 125 lm/w ose më e lartë **(për të përmbushur fluksin e ndriçimit dhe të ketë konsum të moderuar).**

Fluksi i dritës të jetë 12500 lm-15000lm ose më e lartë **(për të përmbushur fluksin e ndriçimit dhe të ketë konsum të moderuar).**

Të ketë shkarkues tensioni jo më të vogël se SP 10KV **(për të siguruar mbrojtjen e ndriçuesit nga shkarkimet atmosferike).**

Shkalla e mbrojtjes nga goditjet mekanike IK 08-10 ose më e lartë **(për të mbrojtur ndriçuesin nga goditjet mekanike).**

Shkalla e mbrojtjes nga pluhuri dhe lagështira IP64-66 **(për të mbrojtur ndriçuesin nga pluhuri dhe lagështira).**

Mënyra e montimit në shtyllë me dy mënyra me krahë dhe direkt në shtyllë në majë të saj **(për të evituar pengesat e qarkullimit rrugor ose pemët në vendet ku përbën problem vendosja e krahut të ndriçimit).**

Diametri i tubit të montimit $\varnothing$ 50-60mm (sepse krahët e ndriçimit janë me këtë diametër).

Të ketë rregullim këndit të ndriçimit (për të evituar pengesat e qarkullimit rrugor ose pemët në vendet ku përben problem vendosja e krahut të ndriçimit).

Ngjyra e ndriçimit 4000K (për të ruajtur uniformën e ndriçimit pasi ndriçuesit ekzistues janë më këtë ngjyrë drite, si edhe është efikas në ditë me mjegull).



7- NDRIÇUES RRUGOR LED 4000 K 100W-120W INTELIGJENT

Ndriçuesi Rrugor Led Inteligjent duhet të ketë fuqi 100-120 W (për kursim energjie dhe jetëgjatësi të ndriçuesit).

Ngjyra e ndriçimit duhet të jetë natyrale 4000K (për të ruajtur uniformën e ndriçimit pasi ndriçuesit ekzistues janë më këtë ngjyrë drite, si edhe është efikas në ditë me mjegull).

Efiçenca e ndriçuesit 130 lm/w ose më e madhe (për të përmbushur fluksin e ndriçimit dhe të ketë konsum të moderuar).

Fluksi ndriçimit 13000 lm - 15600 lm ose më e madhe (për të përmbushur fluksin e ndriçimit dhe të ketë konsum të moderuar).

Shkalla e mbrojtjes nga lagështira dhe pluhuri IP64-66 (për të mbrojtur ndriçuesin nga pluhuri dhe lagështira).

Jetëgjatësia e ndriçuesit duhet të jetë jo me pak se 65000 orë pune, mbi 5 vjetë (për të evituar avaritë e shpeshta).

Trupi i ndriçuesit të jetë material alumini i lyer dhe ledi i mbuluar me xham termorezistent

Shkalla e mbrojtjes nga goditjet mekanike IK 08-10 (për të mbrojtur ndriçuesin nga goditjet mekanike).

Diametri i tubit të montimit $\varnothing$ 50-60mm (sepse krahët e ndriçimit janë me këtë diametër).

Ndriçuesi duhet të mundësojë rregullimin e këndit të ndriçimit.

Ndriçuesi duhet të ketë mbrojtje nga mbitembioni me shkarkues SP 10 KV dhe mbrojtje nga mbinxehja.

Draiveri i ndriçuesit duhet të jetë plotësisht i programueshëm për të ruajtur të njëjtin fluks ndriçimi me shkallë të reduktimit të fuqisë.

Ndriçuesi duhet të jete i paisur me sensor lëvizje, wireless street lighting management system duke kontrolluar në kohë reale kudo gjëndjen e sistemit të ndriçimit nëpërmjet web interface.



8- PROZHEKTOR LED 6500K 300W

Prozhektori Led duhet të ketë fuqinë 300 W ose më tepër.

Tensioni i punës 220-240V 50-60 Hz (**tensioni më të cilin operon sistemi ynë kombëtar**).

Fluksi i dritës duhet të jetë 25000 lm ose më tepër (për të përmbushur fluksin e ndriçimit dhe të ketë konsum të moderuar).

Shkalla e mbrojtjes nga lagështira dhe pluhuri IP64-66 (për të mbrojtur prozhektorin nga pluhuri dhe lagështira).

Ngjyra e dritës duhet të jetë 6500 K (e bardhë).

Jetëgjatësia jo me pak se 36000 orë pune (për të evituar avaritë e shpeshta).

Prozhektori duhet të ketë krahun e fiksimit në mur ose shtyllë i fiksuar në trupin e vetë me bulona.



9- PANEL KOMANDIMI I KOMPLETUAR 500X400X250mm

Paneli duhet të jetë me përmasa 500x400x250 mm (**Në mënyrë që të ketë mjaftueshem vend për komponentët elektrike**).

Paneli duhet të jetë i pajisur me bazën prej llamarine për fiksimin e elementeve. (**Për montim më të lehtë dhe më të sigurtë të elementeve elektrike**).

Shkalla e mbrojtjes të jetë IP65 ose IP66 (**për të mbrojtur panelin nga pluhuri dhe lagështira**).

Paneli duhet të jetë i pajisur me çelës të veçantë. (**Për të shmangur hapjet e pa autorizuar**).

Shkalla e mbrojtjes nga goditjet mekanike të jetë IK 08-10. **(Për ti rezistuar agjenteve atmosferik).**

Paneli të jetë i lyer me bojë me pjekje **(për ti rezistuar agjenteve atmosferik dhe për jetëgjatësi).**

Trashësia e llamarinës të jetë 1,4-2,0 mm **(për ti rezistuar presionit të ushtruar gjatë pune, dhe për jetëgjatësi të panelit).**

Sipas shkallës së ndriçimit, kontaktore, automat, shkarkues TU, klema dhe shinë për fiksimit të tyre, klemat e panelit dhe rekorderitë e kabllave hyrëse dhe dalëse **(për të realizuar me sukses funksionimin e panelit automatik të ndriçimit).**

Paneli duhet të jetë i pajisur me fashetat e fiksimit në shtyllë **(për një montim të sigurtë dhe të lehtë).**



10- KABËLL ABC 4X16 mm²(AL)

4 x 16 mm² 0.6/1 kV Al,

Frekuenca: Hz 50-60 **(frekuenca me të cilin operon sistemi ynë kombëtar)**

Temperatura maksimale e ambientit: jo më e vogël se 40°C **(që të përballoj temperaturat e nxehta të verës)**

Temperatura minimale e ambientit: -10 °C **(që të përballoj temperaturat e ulëta të dimrit)**

11- KABËLL CU 4X6 mm²

Kabëlli duhet të jetë me përcjellës bakri Klasi 5 (fleksibël) **(për një përcjellshmëri të lartë të rrymës).**

Seksioni kabullit duhet të jetë: 4x6 mm². **(për të përballuar fuqinë e instaluar).**

Izolacioni i përcjellësit të jetë pvc ose standard më i lartë **(për të siguruar një izolim maksimal).**

Izolacioni i kabllit të jetë pvc ose standard më i lartë **(për të siguruar një izolim maksimal).**



12- KABËLL CU 2X1.5 mm²

Kabëlli të jetë me përcjellës bakri **(për te siguruar përcjellje me te mire).**

Përcjellësi i bakrit të jetë fleksibël me izolim PVC të përcjellësit dhe izolim PVC të jashtëm **. (për te siguruar nje izolim maksimal).**



13- IZOLANT ME GJATËSI 0.13mmX19mmX20m

Nastro izolant elektrik shërben për izolimin e kontakteve elektrike nën tension.

Materiali është PVC e qëndrueshme ndaj zjarrit **(vetëshuarse) (për të pasur mbrojtje nga rrjedhjet elektrike si edhe lehtësi në përdorim).**

Ngjyra te jenë te ndryshme sipas kërkesës **(për të pasur uniformë me ngjyrat e përcjellësve elektrik dhe për të lënë shënime në rrjet).**

Specifikime teknike:

Gjatësia 20 metra ose më shumë **(për ulur numrin e nastrove në preventiv dhe për të ulur koston).**

Gjerësia 19 mm ose më shumë **(për të siguruar izolim më të sigurtë të sipërfaqeve të mëdha dhe izolimi të pikave ku lidhen përcjellësat elektrik).**

Trashësia 0,13mm-0,15 mm **(për të siguruar izolim më të sigurtë të përcjellësve elektrik).**



14- TIRANTUES PËR KABËLL ABC 4X16 mm²

Tirantuesi duhet të jetë prodhuar nga material special që mundëson qëndrueshmëri të lartë mekanike dhe rezistencë ndaj ndikimeve atmosferike.

Tirantuesi përdoret për tërheqjen e kablove abc me vetëmbajtje dhe gjithashtu duhet të sigurojë amortizim të forcës tërheqëse të kempatës në mënyrë që të mos dëmtohet kabulli.

Tirantuesi duhet të jetë i përshtatshëm për kablalin 4x16 mm² (ky është kabulli I cili po përdoret në këtë projekt).

(Tirantuesi duhet të jetë i lehtë dhe i shpejtë në montim, i sigurtë dhe efikas në përdorim dhe të përdoret në sistemet njëfazore dhe trefazore).



15- KONTAKTOR 4P 63A ME BOBINË 220V-240V

Kontaktori duhet të ketë rrymë nominale jo më pak se 63 A dhe 4 Polar (për të përballuar ngarkesat e ndriçuesve rrugorë dhe të komandojë fazën dhe neutrin).

Kontaktet e fuqisë duhet të jenë të hapura 4 NO (për të kryer funizimin me energji elektrike në momentin që merr komand nga sensori i muzgut).

Tensioni i punës 220-240 V (tensioni me të cilin operon sistemi ynë kombëtar).

Frekuenca e rrjetit 50-60 Hz (frekuenca me të cilin operon sistemi ynë kombëtar).

Mënyra e lidhjes së përcjellësave me vida (për të siguruar kontakt më të mirë dhe mosrrjedhje të energjisë elektrike).

Montimi bëhet në shinë DIN (panelet ku do montohen janë aktualisht me shina DIN).



16-FOTO ELEMENT 10A-16A,220-240V

Releja (fotoelementi) duhet të ketë markimin CE (për të qënë komfort standardeve europiane).

Kontaktet elektrike duhet të mbajnë jo më i pakë se 10 A (për të përballuar ngarkesën e bobinave të kontaktorëve).

Shkalla e mbrojtjes jo më e vogël se IP44 (**për të siguruar mbrojtje nga pluhuri dhe lagështira**).

Tensioni funizimit 220-240 V (**tensoini me të cilin operon sistemi ynë kombëtar**).

Frekuenca e rrjetit 50-60 Hz (**frekuenca me të cilin operon sistemi ynë kombëtar**).

Materiali plastik duhet të jetë rezistent ndaj rrezeve ultraviolette (**për ti rezistuar kushteve atmosferike**).



***Shënim: Në respektim të nenit 36 të Ligjit Nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, në të gjitha rastet kur përmendet “markë” pranohet termi “ose ekuivalent i tij/i saj”.**

***Shënim: Në kuptim të nenit 36 të Ligjit Nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, pika 3/b, që specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit kontraktor, duke iu referuar standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve apo përdorimin e produkteve. AK pranon edhe mundësinë e paraqitjes së standardit SSH/EN/ISO, mbi konformitetin e standardit europian, dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë.**

Specifikimet teknike u hartuan nga specialistet e fushës, duke marrë në konsideratë nevojat e Autoritetit Kontraktor, në përputhje me përcaktimet e Nenit 36 “Specifikimet teknike” të Ligjit Nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, e Nenit 40 pika 2, si edhe të Nenit 44 “Kërkesat e cilësisë” të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

Specifikimet teknike janë hartuar nga struktura të specializuara/grup pune për objektin që prokurohet, i ngritur me Urdhër të Titullarit të Autoritetit Kontraktor për argumentimin e fondit limit, hartimin e preventivit, përcaktimin e specifikimeve teknike, si edhe hartimin dhe argumentimin teknikisht dhe ligjërish të kriterëve të veçanta të kualifikimit. Specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, si edhe janë në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021,

“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti tij/saj”. Specifikimet teknike shprehin tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar dhe në përputhje të plotë me funksionet e kërkuara nga Autoriteti Kontraktor.

Shtojca 7.

(Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT

Sasia e mallit që kërkohet:

PREVENTIV

Nr	Përshkrimi	Njësia	Sasia
1	SHTYLLA BETON ARME H=8m	Copë	50
2	KRAH NDRIÇIMI I ZINGUAR ø50ME DY FASHETA ø150mm- ø200mm	Copë	600
3	QAFORË PËR SHTYLLA BETONI ARME ME ø150mm- ø200mm	Copë	600
4	KONEKTOR LINJE	Copë	100
5	KONEKTOR ABONENTI	Copë	1400
6	NDRIÇUES RRUGOR LED 4000 K 100W-120W	Copë	614
7	NDRIÇUES RRUGOR LED 4000 K 100W-120W INTELIGJENT	Copë	19
8	PROZHEKTOR LED 6500K 300W	Copë	20
9	PANEL KOMANDIMI I KOMPLETUAR 500X400X250mm	Copë	11
10	KABËLL ABC 4X16 mm ² (AL)	ML	18000
11	KABËLL CU 4X6 mm ²	ML	200
12	KABËLL CU 2X1.5 mm ²	ML	1403
13	IZOLANT ME GJATËSI 0.13mmX1.9cmX20m	Copë	202
14	TIRANTUES PËR KABËLL ABC 4X16 mm ²	Copë	1300
15	KONTAKTOR 4P 63A ME BOBINË 220V-240V	Copë	50
16	FOTO ELEMENT 10A-16A,220-240V	Copë	52

Afatet e lëvrimit: Afati i dorëzimit të mallit është brenda 45 (dyzetë e pesë) ditëve nga momenti i nënshkrimit të kontratës.

Artikulli	Përshkrimi	Shuma	Destinacioni	Periudha e dorëzimit
-----------	------------	-------	--------------	----------------------

1.	“Blerje materiale elektrike për ndriçimin në rrugët e territorit të Bashkisë Divjakë ”	16,666,614 (gjashtëmbëdhjetë milionë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e katërmëdhjetë) lekë pa Tvsh	Në magazinën e Bashkisë Divjakë	45 (dyzetë e pesë) ditë nga momenti i nënshkrimit të kontratës.
----	---	--	--	--

GRAFIKU I LËVRIMIT TË MALLIT

Artikulli	Përshkrimi	Sasia	Destinacioni	Periudha e dorëzimit
1	SHTYLLA BETON ARME H=8m	10	Njësia Administrative Divjakë	45 ditë
		10	Njësia Administrative Remas	45 ditë
		10	Njësia Administrative Gradishtë	45 ditë
		10	Njësia Administrative Grabjan	45 ditë
		10	Njësia Administrative Tërbuf	45 ditë
2	KRAH NDRIÇIMI I ZINGUAR ø50 ME DY FASHETA ø150mm- ø200mm	120	Njësia Administrative Divjakë	45 ditë
		120	Njësia Administrative Remas	45 ditë
		120	Njësia Administrative Gradishtë	45 ditë
		120	Njësia Administrative Grabjan	45 ditë
		120	Njësia Administrative Tërbuf	45 ditë
3	QAFORE PËR SHTYLLA BETONI ARME ME ø150mm- ø200mm	120	Njësia Administrative Divjakë	45 ditë
		120	Njësia Administrative Remas	45 ditë
		120	Njësia Administrative Gradishtë	45 ditë
		120	Njësia Administrative Grabjan	45 ditë
		120	Njësia Administrative Tërbuf	45 ditë

4	KONEKTOR LINJE	20	Njësia Administrative Divjakë	45 ditë
		20	Njësia Administrative Remas	45 ditë
		20	Njësia Administrative Gradishtë	45 ditë
		20	Njësia Administrative Grabjan	45 ditë
		20	Njësia Administrative Tërbuf	45 ditë
5	KONEKTOR ABONENTI	280	Njësia Administrative Divjakë	45 ditë
		280	Njësia Administrative Remas	45 ditë
		280	Njësia Administrative Gradishtë	45 ditë
		280	Njësia Administrative Grabjan	45 ditë
		280	Njësia Administrative Tërbuf	45 ditë
6	NDRIÇUES RRUGOR LED 4000 K 100W- 120W	120	Njësia Administrative Divjakë	45 ditë
		120	Njësia Administrative Remas	45 ditë
		134	Njësia Administrative Gradishtë	45 ditë
		120	Njësia Administrative Grabjan	45 ditë
		120	Njësia Administrative Tërbuf	45 ditë
7		19	Njësia Administrative Divjakë	45 ditë

	NDRIÇUES RRUGOR LED 4000 K 100W- 120W INTELIGJENT	0	Njësia Administrative Remas	45 ditë
		0	Njësia Administrative Gradishtë	45 ditë
		0	Njësia Administrative Grabjan	45 ditë
		0	Njësia Administrative Tërbuf	45 ditë
8	PROZHEKTOR LED 6500K 300W	4	Njësia Administrative Divjakë	45 ditë
		4	Njësia Administrative Remas	45 ditë
		4	Njësia Administrative Gradishtë	45 ditë
		4	Njësia Administrative Grabjan	45 ditë
		4	Njësia Administrative Tërbuf	45 ditë
9	PANEL KOMANDIMI I KOMPLETUAR 500X400X250mm	3	Njësia Administrative Divjakë	45 ditë
		2	Njësia Administrative Remas	45 ditë
		2	Njësia Administrative Gradishtë	45 ditë
		2	Njësia Administrative Grabjan	45 ditë
		2	Njësia Administrative Tërbuf	45 ditë

10	KABËLL ABC 4X16 mm ² (AL)	360	Njësia Administrative Divjakë	45 ditë
		360	Njësia Administrative Remas	45 ditë
		360	Njësia Administrative Gradishtë	45 ditë
		360	Njësia Administrative Grabjan	45 ditë
		360	Njësia Administrative Tërbuf	45 ditë
11	KABËLL CU 4X6 mm ²	40	Njësia Administrative Divjakë	45 ditë
		40	Njësia Administrative Remas	45 ditë
		40	Njësia Administrative Gradishtë	45 ditë
		40	Njësia Administrative Grabjan	45 ditë
		40	Njësia Administrative Tërbuf	45 ditë
12	KABËLL CU 2X1.5 mm ²	283	Njësia Administrative Divjakë	45 ditë
		280	Njësia Administrative Remas	45 ditë
		280	Njësia Administrative Gradishtë	45 ditë
		280	Njësia Administrative Grabjan	45 ditë
		280	Njësia Administrative Tërbuf	45 ditë
13	IZOLANT ME GJATËSI 0.13mmX19mmX20m	42	Njësia Administrative Divjakë	45 ditë
		40	Njësia Administrative Remas	45 ditë
		40	Njësia Administrative Gradishtë	45 ditë
		40	Njësia Administrative Grabjan	45 ditë
		40	Njësia Administrative Tërbuf	45 ditë
		260	Njësia Administrative Divjakë	45 ditë
		260	Njësia Administrative Remas	45 ditë

14	TIRANTUES PËR KABËLL ABC 4X16 mm ²	260	Njësia Administrative Gradishtë	45 ditë
		260	Njësia Administrative Grabjan	45 ditë
		260	Njësia Administrative Tërbuf	45 ditë
15	KONTAKTOR 4P 63A ME BOBINE 220V- 240V	10	Njësia Administrative Divjakë	45 ditë
		10	Njësia Administrative Remas	45 ditë
		10	Njësia Administrative Gradishtë	45 ditë
		10	Njësia Administrative Grabjan	45 ditë
		10	Njësia Administrative Tërbuf	45 ditë
16	FOTO ELEMENT 10A-16A,220-240V	12	Njësia Administrative Divjakë	45 ditë
		10	Njësia Administrative Remas	45 ditë
		10	Njësia Administrative Gradishtë	45 ditë
		10	Njësia Administrative Grabjan	45 ditë
		10	Njësia Administrative Tërbuf	45 ditë

Shtojca 8.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

OFERTUESI DEKLARON SE:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënua për ndonjë veprë penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënua ose nuk ka qenë i dënua nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo veprë penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.
- j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.
- k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 9.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/Enti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet:

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9;

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.1.1 Sipas Shtojcës 8, pika 1 "Kriteret e përgjithshme të përzgjedhjes/kualifikimit"

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Vërtetim nga administrata tatimore për xhiron e realizuar në 3 (tre) vitet e fundit 2022, 2023 dhe 2024 nga shoqëria, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar, duhet të jetë jo më e vogël se dyfishi i vlerës së përlllogaritur të kontratës që po prokurohet.

2.2.2 Operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duhet të paraqesin vërtetimet që dëshmojnë se kanë paguar detyrimet përkatëse, të taksave dhe tarifave vendore, në përputhje me percaktimet e Ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar, në të gjitha

vendet ku kanë ushtruar aktivitet sipas të dhënave të QKB-së, për vitin 2024 dhe detyrimet e maturuara për vitin 2025.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit të BOE, duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Njësitë Administrative përkatëse ku ka ushtruar apo ushtron aktivitet për vitin 2024 dhe detyrimet e maturuara për vitin 2025, sipas të dhënave të QKB-së.

Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9 të DST.

Shënim: *Në lidhje me momentin e paraqitjes së dokumentacionit dëshmues për kërkesat që përfshihen në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten në rastin kur OE shpallet fitues, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor, referuar pikës 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, ku parashikohet: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, dhe në këto rregulla”, si edhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin”.*

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së përlogaritur të kontratës që po prokurohet.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a. për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.
- b. për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.

2.3.2 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të jetë i pajisur me çertifikatat e mëposhtme: Çertifikatën e cilësisë **SSH/EN/ISO 9001:2015** (Standard për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë).

(Certifikata si më sipër duhet të paraqitet origjinale ose kopje e noterizuar, e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë)

Ne rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar duhet të paraqesë çertifikatën **SSH/EN/ISO**, pasi duhet t'i disponojë në raport me zërat, përqindjen e marrë përsipër, sipas angazhimit me shkrim / kontratës së bashkëpunimit.

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqesë një deklaratë, ku me anë të së cilës, duhet të deklarojë, se të gjitha mallrat e ofruara, janë në përputhje me parametrat teknike të kërkuara, si edhe sipas specifikimeve teknike të kërkuara nga Autoriteti Kontraktor në Dokumentat Standarde të Tenderit.

2.3.4 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqesë me anë të një deklarate, se mallrat e kërkuar sipas preventivit, duhet të kenë garanci jo më pak se 5 vite për NDRICUESAT RRUGOR LED objekt të kësaj kontrate dhe 2 vite për mallrat e tjera të ofertuara, duke filluar nga momenti i furnizimit.

2.3.5 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqesë një deklaratë, ku me anë të cilës të deklarojë se, merr përsipër të kryejë furnizimin dhe shërbimin e transportit të mallit të kërkuar pranë Bashkisë Divjakë, sipas nevojave të Autoritetit Kontraktor, brenda afateve, sasive dhe specifikimeve teknike të përcaktuara.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Shtojca 9.

(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

I. Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik _____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

Identifikimi	Përgjigjja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE)	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	-----
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	-----
E-mail:	----- ---

B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se: Informacione për nënkontraktorin
--

Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT – i	Përqindja e nënkontraktimit	Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t'u nënkontraktuar

- Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata
Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____

Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë: etj. nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv). <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
